

Analiza&Komente

A kanë kontratat afatshkurtra gjini?



Dita Dobranja

Tregu i punës në Kosovë ka mangësi të shumta, duke filluar nga ajo më problematike që është mungesa e vendeve të punës, hendeku në mes të aftësive që kërkohen nga punëdhënësit dhe ato që i ofrojnë punëkërkuarit, problemet me zbatimin e Ligjit të Punës nëpër vendet e punës ekzistuese e deri te mungesa e sigurisë në punë - qoftë ajo fizike ose si rezultat i mungesës së kontratave. Në të gjitha problemet ka kategori të punëkërkuarve dhe punëtorëve që preken më shumë se të tjerët. Në masë të madhe, rinia dhe gratë mbesin të nënpërfaqësuar në tregun e punës. Një problem i tillë cilësohen edhe kontratat afatshkurtra. Punëtorët që posedojnë kontrata afatshkurtra ballafaqohen me një sërë pasigurish, të cilat fillojnë me pamundësi të planifikimeve afatgjata dhe vazhdojnë me pozitën e pafavorshme negociues kundrejt punëdhënëseve. Sidoqoftë, kontratat afatshkurtra si dukuri janë në rritje nëpër botë. Arsyeja e parë për këtë është rifokusimi i ekonomisë globale drejt shërbimeve, e pasqerësht i shërbimeve në sektorin e teknologjisë informative - sektor ky që kërkon shumë më afatshkurtra dhe kontratat

Sallorët e së Martës janë një risinë lavore e Institutit Demokraci për Zhvillim (D4D). Sallorët ka format gjysmeformal sipas rregullës "Chattham House" dhe pa prani të mediave. Diskutimi mbledh rreth vetes eksperitë e analistë politikane e publikiste për të reflektuar dhe kërkuar kon-sensus midis barnat e përzgjedhura. Fjala e hapjes postohet në kanalën e sallorëve në YouTube. Secili Sallor përcillet me editorial që publikohet në "Zëri" të martën e ardhshme dhe

kushte më të pafavorshme të punës - qofshin ato në formë kompensimi, të orarit, apo edhe të pagesës së benefiteve. Ajo që i bën këto kontrata shumë më problematike për gratë është edhe fakti që kontratat afatshkurta përdoren edhe si formë legale për të shpëputur kontratat me gratë që janë në proces të krijimit të familjes.

Një nga arsyetimet që vjen nga sektori privat për shkelje të tilla është vetë barra e kushtueshme që bizneset duhet ta paguajnë, sipas Ligjit të Punës, në rast të shtatzënisë së punëtorëve të tyre. Kontratat afatshkurtra skadojnë, ato nuk duhet të ndërpriten në rast të shtatzënisë dhe kështu punëdhënësit mënjanojnë barrën që ato parashihet ta mbajnë - atë të pagesës së 70% të rrogës së një punëtorëve gjatë 6 muajve të parë të pushimit të lehonisë. Kjo dispozitë nuk vlen edhe për ballarët dhe në këtë mënyrë punëdhënësit me shumë gjasa i ofrojnë kontrata afatshkurta grave se burrave kur i punësojnë.

Në anën tjetër, argumenti që duke pasur parasysh faktin që një numër i madh i punëtorëve në

Arsyeja tjetër është kriza ekonomike globale dhe ndikimi i saj në rritjen e kujdesit nga ana e sektorit privat për të mos investuar apo planifikuar përtej të ardhmes së afërt.

Kontratat afatshkurta, nëse përdoren pa tendenca të keqpërdorimit të punëtorëve, janë të nevojshme në një treg dinamik dhe sezonal. Në Kosovë, duke pasur parasysh indikatorët ekonomikë, është tejet e vështirë për sektorin privat të përpilojnë plane afatgjata, të tilla të cilat parashohin edhe planifikimin e fuqisë punëtoare. Duke i shtuar kësaj edhe strukturën ekonomike të bazuar në konsum, e cila ndikohet nga faktorë sezonalë siç është diaspora, rritja sezonale dhe afatshkurtë e aktivitetit ekonomik e vë në pah nevojën për ekzistencën e kontratave të punës për t'i akomoduar këto trende. Sidoqoftë, keqpërdorimi i tyre përtej nevojave të tilla është arsyeja prapa debatit në Kosovë, i cili fokusohet në aspektin negativ të kontratave afatshkurta, veçanërisht ndikimin e tyre tek gratë. Në Kosovë gratë kanë shkallën më të lartë të joaktivitetit ekonomik në rajon, ku mbi 80% e grave të moshës së punës as nuk kërkojnë punë. Tek ato të cilat kërkojnë punë niveli i papunësisë është rreth 37%. Kjo i rrit gjasat që gratë të pësojnë nga pasiguria e tregut.

Si? Sepse kur vetëm 18% e grave në Kosovë kërkojnë punë dhe prej tyre vetëm 63% janë të punësuarara pozita e grave në tregun e punës është shumë e pafavorshme. Kjo pozitë pastaj i shtynë gratë të pranohet vende të punës me kushte të cilat shumë shpesh janë edhe eksploative. Kontratat e tilla shpesh shërbejnë për ta përmirësuar pozitën e negociuese të punëdhënësit kundër punëtoareve të tyre, duke i dhënë mundësi të ofrojnë

Kosovë punojme pa kontrata, ekzistenca e çitaredo kontratave, qofshin ato afatshkurta ose me afat të caktuar, duhet të konsiderohet pozitive, ka bazë në realitetin e tregut të punës në Kosovë. Nëse kontratat afatshkurta rezultojnë nga orientimi më i madh i ekonomisë tek teknologjia informative, po ashtu duhet të konsiderohet pozitive.

Mirëpo, në raste kur këto kontrata shfrytëzohen për keqpërdorimin e punëtorëve, duhet të rishikohen të gjitha format që të mos lejohet një gjë e tillë. Një hap i tillë mbetet amendamenti i Ligjit të Punës, për të balancuar barrën e punëdhënësit gjatë pushimit të lehonisë, për t'i dekurajuar punëdhënësit të diskriminojnë gratë në punë me kushte dhe kontrata të papërshtatshme.

Kontratat afatshkurta dhe keqpërdorimi i tyre përfundimisht shpërfaqin disprepancën në mes të mundësiave biznesore dhe politikave publike në Kosovë. Problemet diskriminuese në tregun e punës me të cilat ballafaqohen gratë në baza ditore janë po aq rezultat i politikave të mangëta publike, sa janë rezultat i praktikave të sektorit privat. Përmirësimi i politikave publike, monitorimi i zbatimit të tyre, minimizimi i mundësiave dhe arsyeve për sektorin privat të diskriminojë dhe keqpërdorë punëtorët në baza gjimore, ndikojnë në përmirësimin e situatës në treg. Rishikimi i dispozitave ligjore që hapin rrugë për diskriminim gjinor në praktikë, duhet të analizohet dhe adresohet nga vetë institucionet shtetërore. Dhe mbi të gjitha, duhet të rritet vetëdija për praktikën e pandërgjegjshme biznesore dhe për raportimin e tyre tek inspektoratet dhe organet tjera përgjegjëse, që edhe punëtorët t'i gëzojnë të drejtat e tyre dhe bizneset të mos ekspozohen ndaj problemeve të tilla në tregun e punës.

te D4D së. Përdastet bazuar në editorial mund t'i gjera të uebtegen tone

<http://www.zeri.info>

like >
facebook.com/gazetazeri
follow >
twitter.com/gazeta_zeri



> Në këtë hapësirë, "Zeri" boton opinione, analiza, veshtrime, qasje, reagime dhe letra të lexuesve. Shkrimet nuk duhet të jenë më të gjata se 800 fjalë

> Redaksia mban të drejtën e shkurtimeve të materialeve të kësaj rubrike, apo edhe të mosbotimit të tyre, në rast se shkrimet për këtë rubrikë janë joprofesionale dhe joetike. Redaksia nuk qendron prapa opinionëve që botohen në këto faqe.